



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 1246/1 Prot.

Fier, më 17.12 2020

**Lënda:** Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve 88 dhe 89 të Këshillit Bashkiak Roskovec datë 02.12.2020

**Drejtuar:** Znj. Majlinda BUFI

KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC.

Z. Kadri HYSKA

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

**ROSKOVEC**

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 6671 prot. datë 04.12.2020, bazuar në Ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "a" dhe 16 pasi shqyrtuam ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec të marra në mbledhjen e datës 28.09.2020 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet konfirmojmë si më poshtë:

**Vendimi Nr. 88 datë 02.12.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2021"** Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" (i ndryshuar) neni 8 pika 2; neni 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja "b" dhe neni 54 shkronja "f"; Ligjin Nr. 9936 Datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 9632, Datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar); Ligjin Nr.68 Datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" kreu III, Ligjin 9975 datë 28/07/2008 "Për taksat kombëtare" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 10296 Datë 08/07/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9920 Datë 19/05/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 10081 Datë 23/02/2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"(i ndryshuar); Ligjin Nr.8450 datë 24/02/1999 "Për përpunimin transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" (i ndryshuar); VKM Nr.1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave"; Ligjin Nr. 10465 datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin Nr. 8098 datë 23.03.1996 "Për statusin e të verbërit" (i ndryshuar); Ligjin Nr.8626 datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" (i ndryshuar); Ligjin Nr

7889, datë 14.12.1994 "Status ii invalidit" (i ndryshuar); VKM nr.132, datë 7.3.2018 për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" (i ndryshuar).

**Vendimi nr. 89 datë 02.12.2020 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për miratim e Buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërrmarrjeve vartëse si dhe niveli maksimal i pagave për vitin 2021"** Eshtë në përputhje me ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar) neni 8 pika 2; neni 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja "b" neni 54 shkronjat "ç" dhe "dh", Ligjin Nr 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", nenet 39; 40 dhe 41 të tij, Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 "Per Menaxhimin e sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqiperise" (i ndryshuar) nenet 15 dhe 32 të tij Udhezimi Nr.9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit".

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,**

**PREFEKTI**

**Baki BALA**



**Në mungesë dhe me urdhër**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Arben VELO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6676 Prot.

Roskovec, më 04.12, 2020

VENDIM

NR. 88. DATË 07.12. 2020

**“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2021”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

Të miratojë strukturën dhe nivelet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 që janë paraqitur si më poshtë:





## **KAPITULLI I**

## **TAKSAT VENDORE**

### ***1.1 Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël***

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetëmillion ) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

**Baza e taksës/tatimi :** Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) million lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohet me udhezim të Ministrit të Financave. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës/tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

### ***1.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme***

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme , në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari apo bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë të cilat nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përshihen:

- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi truallin

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë( ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësoj sipërfaqen e taksueshme.

#### **I.2.1 Taksa mbi ndërtesat**

**Baza e taksës:** Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

1. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi që shfrytëzohen për banim/strehim ne Bashkinë Roskovec është 30,000 leke/m<sup>2</sup> sic përcaktohet ne VKM Nr.132, datë 7.3.2018
2. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori



përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.

3. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
4. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi për parkim i hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
5. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve.
6. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.
7. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat ju bashkuan njërive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 115/2014, reduktohet 10 (dhjetë) për qind.
8. Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" i ndryshuar, çmimi për meter katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

**Niveli i taksës mbi ndërtesat:** Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

**Nënkategoritë e ndërtesave/njësive pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim, jepen si më poshtë:**

1. Ndërtesa, e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;
2. Garazhet e mbyllura;
3. Bodrumet;
4. Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.





**“Ndërtesa të tjera” përfshihen:**

1. Ndërtesa për tregëti dhe shërbime
2. Parkim të mbuluar dhe bodrume
3. Parkim i hapur
4. Ndërtesa për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme
5. Ndërtesat që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve buqësore dhe blegtorale

**Detyrimi për pagesë:** Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Zyra e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Mbledhja e kesaj takse behet me agjent tatimore te percaktuar nga NJQV.

**Përfshihen nga pagesa për taksën e ndërtesës së banimit familjet:**

1	Me ndihme ekonomike	Po
2	Tetraplegjik, paraplegjik	Po
3	Te verberit	Po
4	Invalid pune dhe të luftës	Po
5	Veteranet e luftes	Po

Perjashtimi behet kur perfituesi eshte kryefamiljar dhe e verteton statusin me dokument ligjor. Ky perjashtim vlen kur tatimpaguesi nuk merret me aktivitet privat.

**Përfshitime:** Përfshihen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- e) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- g) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “*brand name*”;
- h) Ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paafitë për punë
- i) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;



- j) ) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :** Detyrimi për familjet dhe bizneset llogaritet nga Drejtoria e te Ardhurave dhe shlyhet pranë arkës, Posta sh.a ose në çdo bank të nivelit të dytë, brenda 20 prill të vitit fiskal për ndërtesat që shfrytëzohen për veprimtari ekonomike dhe deri në 31 dhjetor për familjarët.

**Shpërndarja e njoftim detrimeve të taksapagueseve do të bëhet :**

**1.Me poste**

**2.Në mënyre elektronike kur taksapaguesi e ka pranuar kete forme komunikimi**

**3. Me libër dore nga punonjës të bashkisë**

#### **I.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore**

Përkufizimi: **“Tokë bujqësore”** është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë. Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar , në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqiten si më poshtë:

Kategorit mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore			
		Bashkia	Kuman	Strum	Kurjan
I	Lekë/ha/vit	5600	5600	5600	5600
II	Lekë/m2/vit	4900	4900	4900	4900
III	Lekë/m2/vit	4200	4200	4200	4200
IV	Lekë/m2/vit	3600	3600	3600	3600
V	Lekë/m2/vit	3000	3000	3000	3000
VI	Lekë/m2/vit	2400	2400	2400	2400
VII	Lekë/m2/vit	1800	1800	1800	1800





Detyrimi për pagesë : Detyrimi mbi taksën e tokës bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga zyra e taksave dhe shlyhet në arke, në bankat e nivelit të dytë ose Postën Shqiptare në bazë të një kontrate të lidhur me këtë të fundit.

❖ **Per taksen e tokes bujqesore te zbritet 30% e detyrimit te vitit 2021 , per arketimet e kryera deri me 30.06.2021.**

Per Fshatin Marinez banoret qe jane te pajisur ne baze te ligjit 7501 me toke bujqesore brenda zones industriale do te paguajne ½( nje te dyten) e detyrimit per kete toke . Kjo e vertetuar nga komisioni i posacem qe do te ngrihet.

### **Përfshirje :**

Përfshihen nga taksa e tokës bujqësore:

- a. sipërfaqja e tokës bujqësore që mbillet me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
- b. Përsonat si më poshtë:

1	Tetraplegjik, paraplegjik	Po
2	Te verberit	Po
3	Invalid pune dhe të luftës	Po
4	Veteranet e luftes	Po

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Strukturat e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore, për të gjitha kategoritë, është zyra e të ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë. Drejtoria e Bujqësisë pranë Bashkisë Roskovec ngarkohet për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar ndryshime të herëpashershmë dhe ia përcjell këtë informacion Zyrës së të Ardhurave për llogaritjen e detyrimit.

### **I.2.3 Taksa mbi truallin**

**Përkufizimi:** Truall është sipërfaqja e tokës, jo bujqësore, jo hapësirë publike që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumentave ligjore të planifikimi, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

**Baza e taksës:** Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si mëposhtë :





Taksa mbi truallin	Njesia	Niveli i taksës mbi truallin
Për qëllime banimi nga individët	Lekë/m2/vit	0.14
Për qëllim biznesi	Lekë/m2/vit	12

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :

Detyrimi për familjet dhe bizneset llogaritet nga Drejtoria e të Ardhurave dhe shlyhet pranë arkes, Posta sh.a ose në çdo bank të nivelit të dytë, brenda 20 prill të vitit fiskal për truallin për qëllim biznesin dhe deri në 31 dhjetor për familjarët.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i taksës së truallit për familjet llogaritet për një sipërfaqe prej 250 m2.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i sipërfaqes së truallit për bizneset llogaritet në bazë të sipërfaqes së ndërtesës së aktivitetit. **I.3 Taksa e fjetjes në hotel**

**Baza e taksës:** Është numri i netëve të qëndruara në hotel për një person.

Niveli i taksës paraqitet si më poshtë:

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli I taksës së fjetjes në hotel
Hotel 4-5 yje	Lekë/natë qëndrimi /për person	105
Bujtine, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese	Lekë/natë qëndrimi /për person	35

**Detyrimi dhe kështet e pagimit:** Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.

**Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës:** Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave Vendore.



### I.3 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

**Baza e taksës:** Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë		
	Në % të çmimit të shitjes për m <sup>2</sup> ose e vlerës së preventivit	Bashkia Roskovec	Njësitë e tjera
Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industris apo për përdorim publik.	4%- 8%	4%	4%

Baza e taksës: Vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njërive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “ Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë		
	Në % të vlerës së investimit	Bashkia Roskovec	Njësitë e tjera
Ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër	1-3	2%	2%
Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare etj.	0.1 por jo me pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit	0.1	0.1
Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5 e vlerës së investimit	0.5	0.5

**Baza e taksës :** Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit. Detyrimi i taksës i takon investitorit.

Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjen përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqen respektive.

Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.





Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila përcjell informacionin tek Zyra e të Ardhurave. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Roskovec, vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Struktura për vjeljen e taksës është Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Roskovec.

**Përfshihen nga pagesa e kësaj takse:**

- a. investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".
- b. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

**I.4 Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:**

Garancia financiare: Në mbështetje të pikës 10 të VKM-së Nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", subjekt fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, **kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit**, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3 % e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht Drejtoria e Urbanistikës, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr.575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provoj se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4,5 dhe 6, të VKM Nr. 575 në landfillin ose në venddepozitim të përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimit: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së garancisë financiare është Drejtoria e Urbanistikës. Struktura e ngarkuar për vjeljen e detyrimit është Zyra e të Ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.





### I.5 Taksa e kalimit e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

**Baza e taksës** mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Bashkia Roskovec
Ndërtesa banimi	Lekë/m <sup>2</sup>	100
Ndërtesa të tjera për tregëti dhe shërbime	Lekë/m <sup>2</sup>	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m <sup>2</sup>	200

**Detyrimi për pagesën:** Taksa paguhet nga personi, që kalon e drejta e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";
- c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
  - i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
  - ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose I për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

**Mënyra e mbledhjes:** Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3 % të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit perkatës të bashkisë Roskovec, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës : Ngarkohet Zyra e të Ardhurave pranë Bashkisë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me ZRPP.

### I.6 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura



**Baza e taksës:** Është lloji i mjetit të transportit rrugor

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të rregjistruara sipas njësive vendore, 25% të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon Bashkisë Roskovec në llogari të degës së thesarit.

**I.7 Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare**

**Baza e taksës :** Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industri minerare, sipas një marrëdhënie kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentën minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nën toka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin që ai shet produktin.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor. Degët e doganave në rrethe ngarkohen me arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (34%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Roskovec në degën e thesarit .

**I.8 Taksa e tabelës**

**Baza e taksës:** Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamje ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe shërbejnë për qëllime identifikimi.





Nr.	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	B.Roskovec
<b>I.</b>	<b>Taksë tabelle per qëllime identifikimi, të trupezuara ose jo, brënda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tjereve (ku shenohet emri dhe/ose aktiviteti I biznesit)</b>		
<b>a</b>	deri në 2m	lekë/m2/vit	0
<b>b</b>	<b>mbi 2m2 deri 10m2</b>		
	e thjeshte pa ndricim	lekë/m2/vit	7000
	me ndricim te thjeshte	lekë/m2/vit	11500
	elektronike	lekë/m2/vit	15000
<b>c</b>	<b>mbi 10m2 deri 20m2</b>		
	e thjeshte pa ndricim	lekë/m2/vit	5950
	me ndricim te thjeshte	lekë/m2/vit	9775
	elektronike	lekë/m2/vit	12750
<b>ç</b>	<b>mbi 20m2 deri 40m2</b>		
	e thjeshte pa ndricim	lekë/m2/vit	3850
	me ndricim te thjeshte	lekë/m2/vit	6325
	elektronike	lekë/m2/vit	8250
<b>d</b>	<b>mbi 40m2</b>		
	e thjeshte pa ndricim	lekë/m2/vit	2800
	me ndricim te thjeshte	lekë/m2/vit	4600
	elektronike	lekë/m2/vit	6000
<b>II.</b>	<b>Taksë tabelle për qëllime identifikimi, jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit ne formen dhe permasat e tabelave per orientim</b>		
	Tabela identifikuese	lekë/m2/vit	120
<b>III.</b>	<b>Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri ne tavanin maksimal 35m2</b>		
	e thjeshte pa ndricim	lekë/m2/vit	13500
	elektronike	lekë/m2/vit	2700
<b>IV.</b>	<b>Tabela ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura,panaïre,spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.</b>		
	te te gjitha llojeve dhe permasave	lekë/m2/vit	1000

Ndryshuar me ligji Nr.106/2017 date 30.11.2017

Shënim: Ne llogaritjen e takses per tabelat me te medha se 10 m2, shumes se takses se llogaritur per siperfaqen deri 10m2 do ti shtohet, shuma e takses e llogaritur per diferencen e siperfaqes se mbi 10m2 te shumezuar me tarifen perkatese te takses. P.sh., nje tabelle e thjeshte 15m2, shuma e takses vjetore do te llogaritet  $(10m2 * 7000leke) + (5m2 * 5950 leke) = 70000 + 29750 =$





99750leke/vit.E njejta llogjike llogaritje do te jete edhe per siperfaqet e tabelave mbi 20m2 dhe 40m2.

Per subjektet qe vendosin me shume se nje tablele identifikuese, vetem njera nga dy tabelat identifikuese do te konsiderohet si e tille, kurse tabela tjeter do te konsiderohet si reklame.

Çdo tablele reklamimi qe kalon siperfaqen 35m2 do te konsiderohet sikur eshte 35m2 dhe shuma e takses llogaritet dhe paguhet vetem per kete siperfaqe, pavarsisht madhesisë se saj ne m2.

**Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës :** Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë Bashkisë Roskovec.Detyrimi për bizneset llogaritet nga Zyra e të Ardhurave dhe shlyhet me arke, pranë Posta sh.a ose në çdo bank të nivelit të dytë, brenda 20 prill të vitit fiskal per biznesin .

## KAPITULLI II TARIFAT VENDORE

Ky kapitull trajton tarifatat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementet :

- Llojit të shërbimit , baza e taksueshme , kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohë e kryerjes së tyre, kushtet lehëtsuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

### II.1 Tarifë Regjistrimi Biznesi

Tarifa e regjistrimit paguhet nga bizneset kur regjistrohen për herë të parë pranë Zyres së Tatim –Taksave.Subjekti qe ka me shume se dy vendodhje paguan vetem per adresen ku ka seline kryesore te aktivitetit. Taksapaguesi regjistron çdo vendodhje te biznesit prane Bashkisë Roskovec. Rregjistrimi per here te pare behet perpara se taksapaguesi te filloje aktivitetin e biznesit te tij.

Gjate ketij regjistrimi taksapaguesi detyrohet te jape informacionin e mëposhte:

- I. Ekstraktin e marr nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit
- II. Fotokopje të kartës së identitetit
- III. Adresën e Vendodhjes së biznesit
- IV. Llojin e biznesit qe kryen ne atë vendodhje

Çdo të dhënë ose dokument tjeter , që mund të përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financës:

Tarifë regjistrimi biznesi	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
Sub.fizik vendas/huaj	12000 lekë	10000 lekë	10000 lekë	10000 lekë
Sub.juridik vendas/huaj	15000 lekë	15000 lekë	15000 lekë	15000 lekë
Ambulant	2000 lekë	2000 lekë	2000 lekë	2000 lekë



**Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës :** Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.

## II.2 Tarifa e Tregut

Lloji i Tarifave	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
Shites mishi ne markato	600 lekë/vend	0	0	0
Zenie vendi per gjedhe	100 lekë/vend	0	0	0
Zenie vendi per shpende	10 lekë/vend	0	0	0
Zenie vendi per te imta	30 lekë/vend	0	0	0
Tarife tregu	35 lekë/m2	0	0	0

## II.3 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Përkufizimi : Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet , personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brënda territorit të Bashkisë Roskovec dhe njësisive të saj administrative. te cileve u ofrohet ky sherbim.


Niveli i tarifës së pastrimit : Kategoritë, nenkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë 1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjet

FAMILJARET ( për familje )	Lekë /vit
Njësia Administrative Roskovec	1200
Njësia Administrative Strum	700
Njësia Administrative Kuman	700
Njësia Administrative Kurjan	700

### Përjashtohen nga pagesa për tarifën e pastrimit familjet:

1	Me ndihme ekonomike	Po
2	Tetraplegjik, paraplegjik	Po
3	Te verberit	Po
4	Invalid pune dhe të luftës	Po
5	Te perndjekurit politik	Po
6	Veteranet e luftes	Po
7	Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes);	50%
8	Kryefamiljarët gra ( te ve ose te divorcuara)	50%





9	Kryefamiljare pensionist qe kane persona në ngarkim të tyre që janë të paaftë për pune.	50%
---	---	-----

Perjashtimi bëhet kur përfituesi është kryefamiljar dhe e vërteton statusin me dokument ligjor.

*Për qytetaret e regjistruar në gjendjen civile si banor të qytetit të Roskovec por që jetojnë në një shtet tjetër për pagesën e tarifës se pastrimit duhet të sjellin:*

1. Nje vërtetim që banojnë ose janë resident në shtetin e huaj

2. Dhe /ose fotokopje të pashaportës

*Në baze të vleresimit të dokumentacionit të sjellë pranë zyrës së tatim – taksave do të bëhet dhe përlllogaritja e detyrimit.*

*Baza e llogaritjes së detyrimit do të jetë periudha ditore e qëndrimit (Nr. ditëve \* tarifa e pastrimit vjetore/365) . P.sh 15\*700/365=28.7 lekë*

Tabela 2.


Nr	BIZNESET (sipas lloji të aktivitetit)	ROSKOVEC	STRUM	KUMAN	KURJAN
1.	Fruta - Perime	12 000	8 000	8 000	8 000
2.	Ushqimore e bulmetore	12 000	10 000	10 000	10 000
3.	Mish , Peshke	12 000	10 000	10 000	10 000
4.	Artikuj te ndryshem me pakice	10 000	8 000	8 000	8 000
5.	Market	15 000	10 000	10 000	10 000
6.	Supermarket	20 000	15 000	15 000	15000
